



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2023

Shtojca 11

**[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data 09/03/2023

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “ARJAN - A” Shpk, me adrese Lagjja "Gjok Doçi", Rruga (Bulevardi) "Eles Isufi", selia në katin e parë, ndërtesa me numër pasurie Nr. 5/340, Zona Kadastrale Nr. 2932, tek ish fabrika e makaronave-Peshkopi, Diber.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur e Thjeshtuar/ Mallra.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-58948-02-14-2023.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje dru dhe pelet per ngrohje per vitin 2023”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nenshkrimit te Marreveshjes Kuader.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “ARJAN - A” SH.P.K me Nuis K16604709O, me oferte ekonomike 5,014,030 (pese milion e katermbedhjete mije e tridhjete) Lek pa TVSH,
- 2- Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K me Nuis J87603505T, me oferte ekonomike 5,099,288 (pese million e nentedhjete e nente mije e dyqind e tetedhjete e tete) Lek pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “STELLA” SH.P.K, Nuis J87603505T,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

¹ Ky Formular eshte i aplikueshem nese ka Ankime

Nuk ploteson kriterin 2.3.1 të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate;

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, si dëshmi pranohen vetem faturat tatimore të shitjes, të plotsuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shenohen data, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se OE ka paraqitur fatura blerje mallrash ku nga verifikimi i tyre rezulton që OE “STELLA” SH.P.K të jete blesesi, ndërsa furnizuesit (shitesit) janë operator ekonomikë të tjerë që kanë lidhje me procedurën e prokurimit.

Sa më lart duke qenë se për të përmbushur këto kritere, *Operatorët ekonomikë do të vërtetojnë duke paraqitur faturat tatimore të shitjes* ku shënohen mallrat, shumat dhe vlerat, ky kriter konsiderohet i përmbushur.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur nën nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kritere të përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të

këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “STELLA” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “STELLA” SH.P.K, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “ARJAN - A” Shpk, me adresë Lagjja "Gjok Doçi", Rruga (Bulevardi) "Eles Isufi", selia në katin e parë, ndërtesa me numër pasurie Nr. 5/340, Zona Kadastrale Nr. 2932, tek ish fabrika e makaronave-Peshkopi, Diber, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 5,014,030 (pese milion e katërmbedhete mije e tridhjetë) Lek pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë zyrës së protokollit të Bashkisë Lezhe sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU
